




REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 06.09.2019, Nr. 09-444-53057



Në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 10/2018 të dt. 13/07/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Drejtori i Drejtimit për Arsim, shpall:

KONKURS PLOTËSUES

- 12 mësimdhënës për nivelin arsimor 1 (arsimi fillor), me afat të pacaktuar.
- 2 mësimdhënës për nivelin arsimor 1 (arsim fillor) me afat të caktuar- deri sa të kthehen punëtorët nga pushimet pa pagesë.
- 1 mësimdhënës për nivelin arsimor 1 (arsim fillor) me afat të caktuar- deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë
- 1 mësimdhënës për lëndën: Gjuhë dhe letërsi shqipe-me kohë të caktuar
- 3 mësimdhënës për gjuhë gjermane nivelin arsimor 1 (arsim fillor) me afat të pacaktuar.
- 1 mësimdhënës për nivelin arsimor 3 – (arsim i mesëm i lartë) lënda gjuhë gjermane- 20 orë, me afat të pacaktuar

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet përgatitje adekuatë profesionale (me fakultete përkatëse), sipas Udhëzimeve Administrative të cekura në paragrafje të këtij konkursi, ndërsa në mungesë të kualifikimit përkatës do të merrën kualifikimet e përafërta.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma noterizuar, ose çertifikatën origjinale e diplomimit- jo më të vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar në Komunë - Noteri publik.
4. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më të vjetër së gjashtë muaj.
5. Vërtetim i përvojës së punës, (ku vlersohet vetëm puna në arsim)
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur me çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.
8. Kopje të Çertifikatave të trajnimeve përkatëse (nëse keni)

REKRUTIMI:

Testin me shkrim dhe intervisten për përzgjedhjen e kandidatëve do të bëjë Komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurrim merret në zyrat e DKA-së, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nuk tërhiqet nga DKA.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas, më: 06.09.2019.



Drejtor për Arsim
Jafil Halilaj